



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 475/2017**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.06.2017 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

“Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e shoqërisë “Adel Co” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-05231-04-11-2017 me objekt: “*Prodhim i revistes periodike Korça*”, me fond limit 975.000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 24.04.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

**Ankimues:**

“Adel Co” sh.p.k  
Rruga “Muhamet Gjollësia”, Zogu i Zi, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Korçë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.04.2017 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. Ref-05231-04-11-2017 me objekt: “*Prodhim i revistes periodike Korca*”, me fond limit 975.000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 24.04.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

II.2. Në datën 09.05.2017 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar.

Sipas këtij klasifikimi renditja e ofertave pa TVSH, është si më poshtë:

- |                           |                            |
|---------------------------|----------------------------|
| 1. “Kotti” sh.p.k         | 412.500 lekë, skualifikuar |
| 2. “Adel Co” sh.p.k       | 435.000 lekë, skualifikuar |
| 3. “Promo Print” sh.p.k   | 488.700 lekë, kualifikuar  |
| 4. “Classic Print” sh.p.k | 499.950 lekë, kualifikuar  |
| 5. “Celesidesign” sh.p.k  | 892.500 lekë, kualifikuar  |

Operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k rezulton se është skualifikuar me argumentin e mëposhtëm:

*“Nga shqyrtimi i argumentimin të ofertës anomalisht të ulët të dorëzuar nga operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k. konstatohet se kjo shoqëri nuk ka argumentuar në përputhje me nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar në lidhje me anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertues, zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si katër kushte kumulative të parashikuara nga ligji për të argumentuar dorëzimin e një oferte anomalisht të ulët për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ankimesi për justifikimin e ofertës anomalisht të ulët, rezulton se operatori ekonomik, bazuar në legjislacionin e sipërcituar, nuk ka paraqitur dokumentacion mbështetës apo provues si: fatura tatimore, fletë zhdoganimi, kontrata furnizimi apo kontrata të mëparshme të lidhura me autoritete të ndryshme, apo ndonjë dokument tjetër, që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë anomalisht e ulët nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Nga ana e operatorit ekonomik janë paraqitur sqarime të cilat nuk janë të mbështetura në fakte e prova që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke mos duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.”*

II.3. Në datën 12.05.2017 operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e mësipërme e prokurimit. Shkurtimeisht pretendohet si vijon:

*“Në datën 02.05.2017 nëpërmjet sistemit elektronik të APP-së njoftohemi se oferta jonë ekonomike është anomalisht e ulët, duke u bazuar në nenin 56 të LPP-së. Me shkresën nr. 205 prot., datë 03.05.2016, dërgohet argumentimi i cmimit nga shoqëria jonë, argumentim i cili ishte i detajuar për të gjitha zërat e shpenzimeve deri në realizimin e produktit përfundimtar. Më datë 09.05.2017 ju keni nxjerrë renditjen ku keni skualifikuar shoqërinë tonë duke mos e marrë për baze argumentimin e ofertës tonë ekonomike. Arsyet tuaja të skualifikimit nuk qëndrojnë dhe skualifikimi jonë është bërë në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik. Duke mos qënë dakort me arsyet tuaja të skualifikimit, po ju parashtrojmë argumentinim tonë:*

*Adel Co sh.p.k ka argumentuar ofertën e saj në bazë të nenit 56 të LPP-së ku kemi dhënë një shpjegim të detajuar se si do të realizohet shtypja e revistës duke përshkruar në mënyrë të hollësishme të gjitha shpenzimet e materialeve që duhen për të realizuar shtypin e revistës, por si shëmbull kemi analizuar vetëm një numër reviste, duke qënë se specifikimet e të gjitha numrave janë njëlloj.*

*Nuk e kuptojmë se çfarë nuk e ka bindur KVO-në pasi argumentimi është shumë i qartë në cdo zë të tij. Në argumentimin tuaj ju shpreheni se nuk kemi provuar me asnjë dokument anën teknike,*

*ndërkohë që bashkëngjitur me argumentimin e cmimit ne ju dërguam edhe faturat tatimore që tregojnë cmimet e blerjes së bazës materiale. Në lidhje me pagat e punonjësve, për shkak se janë konfidenciale, ne nuk mund t'ju japim detaje, por mund ti referoheni pagës minimale dhe maksimale të caktuar me VKM.*

*Ne ju kemi sqaruar saktë shpenzimet për proceset dhe zërat si bazë materiale, paga pune, shpenzime të tjera si dhe fitimin, në mënyrë të detajuar dhe cmimet e vendosura janë të faktuara me fatura TVSH të produkteve që nevojiten për realizimin e kësaj kontrate. Ne ju kemi paraqitur faturën tatimore nr. 3804 e cila tregon cmimin e letrës, faturën tatimore nr. 12319 e cila tregon cmimin e lastrave dhe faturën nr. 8557 e cila tregon cmimin e bojës. Pra baza materiale që duhet për të realizuar revistën është e argumentuar me prova dhe fakte dhe dokumentacion mbështetës që janë faturat tatimore. Me konkretisht po ju sqarojmë edhe një herë si është llogaritur shpenzimi për bazën materiale për një numër reviste si më poshtë:*

- a. Letër 130 gr mat, fomati 70 x 100 cm, 1320 tabak x 13.2 lekë/ tabake = 17.424 lekë. Pra sasia e letërs që duhet për të shtypur 1500 copë reviste është 1320 tabakë dhe cmimi i letrës vërtetohet me faturën nr. 3804.*
- b. Lastra : 18 copë x 500 lekë/copa = 9000 lekë, sasia e lastrave që duhet për të shtypur 1500 copë revista është 18 copë dhe cmimi i lastrave vërtetohet me faturën tatimore nr. 12319.*
- c. Bojë shtypi: 0,8 kg x 1000 lekë/kg = 800 leke, sasia e bojës që duhet për të shtypur 1500 copë revista është 0.8 kg vërtetohet me faturën tatimore nr. 8557.*

*Qëllimi i argumentimit të ofertës është për të justifikuar cmimet, pra anën ekonomike, ndërsa për të garantuar realizimin me sukses të kontratës ne kemi paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DST nga institucioni juaj. Kontratat e ngjashme që ne kemi realizuar me institucione të tjera tregojnë më së miri kapacitetet e shtypshkronjës tonë pasi vlera e kontratave dhe mallrave janë në sasi shume herë më të mëdha sesa kontrata që ju prokuroni.”*

II.4. Në datën 22.05.2017, nëpërmjet shkresës nr. 2200/1 prot., datë 19.05.2017 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit si vijon:

- 1. Mbas KVO ka konstatuar se oferta e paraqitur nga shoqëria Adel Co sh.p.k ishte anomalisht e ulët, me shkresën nr. 1980 prot., datë 02.05.2017 i ka kërkuar kësaj shoqërie shprehimisht:*

*“Mbas llogaritjeve të bëra u konstatua se oferta juaj është me cmim anomalisht të ulët. Në këto kushte, bazuar në LPP, neni 56 , pika 1, kërkojmë nga ana juaj shpjegime për justifikimin e cmimit të ofruar nga ana juaj.*

*Shpjegimet tuaja duhet të konsistojnë sa më poshtë:*

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;*
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;*
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;*

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Mbas paraqitjes së shpjegimeve KVO ka vendosur si më poshtë:

Nga shqyrtimi i argumentimin të ofertës anomalisht të ulët të dorëzuar nga operatori ekonomik "Adel Co" sh.p.k. konstatohet se kjo shoqëri nuk ka argumentuar në përputhje me nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar në lidhje me anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertues, zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si katër kushte kumulative të parashikuara nga ligji për të argumentuar dorëzimin e një oferte anomalisht të ulët për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi për justifikimin e ofertës anomalisht të ulët, rezulton se operatori ekonomik, bazuar në legjislacionin e sipërcituar, nuk ka paraqitur dokumentacion mbështetës apo provues si: fatura tatimore, fletë zhdoganimi, kontrata furnizimi apo kontrata të mëparshme të lidhura me autoritete të ndryshme, apo ndonjë dokument tjetër, që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë anomalisht e ulët nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Nga ana e operatorit ekonomik janë paraqitur sqarime të cilat nuk janë të mbështetura në fakte e prova që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke mos duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme."

3. Nga shqyrtimi i pretendimeve të paraqitura në ankesë dhe shqyrtimit të argumentimeve të paraqitura nga shoqëria Adel Co sh.p.k për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, komisioni i shqyrtimit të ankesës konstaton se:

Argumentimi dhe analiza e sjellë nga shoqëria Adel Co sh.p.k nuk është e plotë dhe në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP-së.

Së pari; Shoqëria Adel Co sh.p.k ka paraqitur vetëm anën ekonomike të ofertës ndërkohë që në nenin 56 të LPP janë katër kushte të cilat duhet të përmbushen në mënyrë që argumentimi të jetë bindës në kuptim të këtij neni. Pra nga ankuesi nuk është dhënë asnjë sqarim lidhur me:

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Së dyti; Edhe analiza e cmimit të paraqitur nuk është e plotë për arsye se kostoja e revistës nuk përbëhet vetëm nga baza materiale por edhe nga paga e punonjësve që do të punojnë për të apo edhe nga shpenzime të tjera sic është shënuar edhe nga ankuesi në argumentimin e tij. Nga ankuesi është shënuar vetëm vlera 30.000 lekë pagë pune për të gjitha numrat e revistës, e pa detajuar.

*Bazuar në dokumentat e tenderit revista është periodike pra nuk do të prodhohen të gjitha numrat njëherësh. Përsa më sipër shënimi i vlerës prej 30.000 lekë si pagë pune pa detajuar pagën, orët e punës apo edhe punonjësit që do të angazhohen, është e pamundur të gjykohet lidhur me respektimin e pagës minimale nga shoqëria Adel Co sh.p.k. E njëjta gjë vlen edhe për zërin shpenzime të tjera i cili është i padetajuar.*

II.5. Në datën 23.05.2017 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 01.06.2017 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 985/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Nr.2417/1 prot., datë 29.05.2017, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Adel Co” sh.p.k mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij me argumentimin se *ka paraqitur ofertë nën koston ligjore*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 2417 prot datë 29.05.2017, rezulton se në datën 02.05.2017 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr. 1980 prot., me objekt “*Kërkesë për argumentimin e ofertës*”, i ka kërkur operatorit ekonomik “Adel Co” sqarim për ofertën ekonomike me vlerë 435.000 lekë. Referuar aktit të mësipërm ndër të tjera Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kërkuar sqarimet si më poshtë vijon: [...]“*Mbas llogaritjeve të bëra u konstatua se oferta juaj është me cmim anomalisht të ulët. Në këto kushte, bazuar në LPP, neni 56 , pika 1, kërkojmë nga ana juaj shpjegime për justifikimin e cmimit të ofruar nga ana juaj.*

*Shpjegimet tuaja duhet të konsistojnë sa më poshtë:*

- c) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;*
- d) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;*
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;*

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi [...]”

III.1.2. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton se në datën 03.05.2017 operatori ekonomik “Adel Co” shpk ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor shkresën nr. 205 prot datë 03.05.2017.

III.1.2.1. Referuar shkresës së mësipërme, operatori ekonomik “Adel Co” shpk ka argumentuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

“ [...] Në përgjigje të kërkesës tuaj, ne po ju paraqesim argumentimin tonë ligjor mbi ndërtimin e ofertës ekonomike si më poshtë vijon:

Nr	Pershkrimi i mallrave	Formati cm	Sasia	Faqe	Baza materiale në lekë	Paga pune ne lekë	Shpenzime të tjera në lekë	Cmimi në lekë	Fitimi në lekë	Shuma totale
	Revista Korca	23x23	7500	20	215.000	30.000	50.000	58	140000	435000

Referuar shpenzimeve të mësipërme për realizimin përfundimtar të produktit, po paraqesim në mënyrë të detajuar shpenzimet për bazën materiale për një numër reviste me sasinë 1500 copë.

Baza materiale për një numër reviste:

- Letër 130 gr mat, fomati 70 x 100 cm, 1320 tabak x 13.2 lekë/ tabake = 17.424 lekë.
- Lastra : 18 copë x 500 lekë/copa = 9000 lekë.
- Bojë shtypi: 0,8 kg x 1000 lekë/kg = 800 leke.
- Celefonim i kapakut : 1500 copë x 4 lekë= 6000 lekë
- Dizenjimi= 9776 lekë

Pra totali për bazën materiale për një numër reviste është : 43.000 lekë x 5 numra = 215.000 lekë.

Bashkëngjitur kësaj shkrese operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k ka paraqitur faturën tatimore nr. 3804 e cila tregon cmimin e letrës, faturën tatimore nr. 12319 e cila tregon cmimin e lastrave dhe faturën nr. 8557 e cila tregon cmimin e bojës.

III.1.3. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
  - zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
  - origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.1.4. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “*Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]*”

III.1.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k si edhe nga përlllogaritjet e kryera Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se oferta ekonomike në vlerën prej 435.000 lekë pa TVSH, në zbatim të nenit 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, rezulton anomalisht e ulët. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar drejt kur gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave i ka kërkuar informacion të detajuar operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k në zbatim të nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III.1.6. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar si e tillë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të aktit normativ në zbatim të ligjit VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjen teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi, duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të



cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimes, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin si dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

K.P.P gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangjen e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, është në disa drejtime, ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore, të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimes, K.P.P. gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin të katër kushtet kumulative të parashikuara nga neni 56 i LPP-së.

III.1.7. Referuar *Shtojcës 1 “Formularit të Ofertës”* të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

1	2	3	4	5	6
Nr.	Përshkrimi i Shërbimeve	Sasia/cope	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
	Prodhimi i revistes te Bashkise Korce (5 numra 1500 cope/numer,me 20 faqe)	7500			
<b>TOTALI (Neto)</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi Total</b>					

III.1.8. Referuar *Shtojcës 8 “Specifikimet teknike”* të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar:

*Specifikimi i Materialeve:*

- *Permasat e nje faqeje 23 cm x 23 cm*
- *Letra 130 gr me lluster/mat*
- *Me ngjyra CMYK*
- *Lidhja me kapse metalike*

*Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **Transporti i revistes do te behet ne Bashkine Korce me automjetin e shoqerise.***

Ndërsa në shtojcën 12 “Termet e referencës” është parashikuar:

*“Sherbimi perfshin dizenjimin dhe shtypshkrimin e 5 numrave me nga 20 faqe 1500 kopje per secilin numer si me poshte:*

*Pranvere 2017 (ku do te pasqyrohet nje permbledhje me te gjithë aktivitetet e muajve te pranveres)*

*Verë 2017 (ku do te pasqyrohet nje permbledhje me te gjithë aktivitetet e muajve te veres)*

*Vjeshtë (shtator-tetor) (ku do te pasqyrohet nje permbledhje me te gjithë aktivitetet e muajit shtator-tetor)*

*Dimër (nëntor-dhjetor) (ku do te pasqyrohet nje permbledhje me te gjithë aktivitetet e muajit nëntor-dhjetor)*

*Botim Special 2017*

*Shperndarja:*

*Per te gjitha botimet kompania duhet te paraqese dorezoje materialin perfundimtar te shtypur ne sasine e parashikuar ne kontrate te revistave jo me vone se nje jave nga data e dorezimit te materialeve qe do te publikohen ne reviste ne CD nga Bashkia Korce.”*

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar informacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ si dhe informacionit të dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor rezulton se, në sqarimet e dhëna për ofertën anomalisht të ulët të dorëzuar nga operatori ekonomik “Adel Co” shpk janë argumentuar shpenzimet për bazën materiale në vlerën 215.000 lekë, të shoqëruar edhe me faturat tatimore për cmimet e materialeve përkatëse. Përveç kësaj së materialeve bazë, në analizën e cmimit të ofertës, ankimuesi ka përfshirë edhe elementë të tjerë si shpenzimet e pagës në vlerën 30.000 lekë, shpenzime të tjera 50.000 lekë si dhe fitimin e shoqërisë 140.000 lekë. Pra ankimuesi ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor analizën e cmimeve me elementët e kësaj, shoqëruar me fatura tatimore që justifikojnë cmimet e materialeve që nevojiten për prodhimin e revistës.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se shoqëria “Adel Co” sh.p.k, ka paraqitur prova dhe fakte të mjaftueshme të cilat krijojnë bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Referuar nenit 1 të ligjit të prokurimit publik, një nga qëllimet e këtij ligji është edhe mirëpërdorimi i fondeve publike, duke rritur efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit, të kryera nga autoritetet kontraktore. Në këtë kontekst, është në interesin e autoritetit kontraktor të pranojë sqarimet e dhëna nga operatori ekonomik “Adel Co”, duke u këshilluar me ofertuesit në bazë të informacionit të paraqitur, për tu bindur për rregullsinë e ofertës.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr. Ref-05231-04-11-2017 me objekt: “*Prodhim i revistes periodike Korca*”, me fond limit 975.000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 24.04.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë ofertues.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 985 Protokolli,**

**Datë 23.05.2017**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Kleves Janku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

**Kryetar**

**Evis Shurdha**